



Skenderbeu ka fituar ne Tirane fale dy golave te shenuar ne pjesen e dyte te ndeshjes. Shume tifoze, shume dyluftime, rivalitet dhe ne fund kampionet kane bere te heshtin ne shtepi bardheblute. Ndeshja e luajtur te dielen ne Qemal Stafa, perfundoi me rezultatin 0-2 ne favor te Skenderbeut qe duhet thene se e meritoi fitoren pas nje loje me te mire se Tirana qe me shume mungesa nuk po del dot ne lojen e saj. Skuadra e Joses zhvilloi me teper presion mbi kundersharet por rastet munguan ne pjesen e pare. Ne dyten, rezultatin e zhbllokoi nje super gol i kroatit Radas qe arriti te dergonte mjeshterisht topin ne porte pas nje goditje standarte nga 30 metra. Tirana u hodh ne sulm per te barazuar por e pati te pamundur ta bente. Dede beri disa ndryshime ne loje por serish skuadra nuk kishte qartesi per te krijuar raste te rrezikshme. Skenderbeu pa Pejic ne fushe per shkak te vendimit te marre nga Josa per ta lene ne stol e kishte gjithashtu te veshtire per te ngacmuar me shume skuadren nga kryeqyteti. Por per ti dhene zgjidhje kesaj ndeshje mendon vete Tirana. Nje mosmarreveshje mes portierit Caka dhe Muces i jep mundesine Ribaj te shenoje golin e qetesise me porten e boshatisur. Tirana bie keshtu ne krize me humbjen e dyte rradhazi ndersa Skenderbeu rigjen qetesine.